



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit për një pozicion të lirë” (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>        | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>11. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
- 7. Përfaqësues të OPDAT-it, të cilët futen në sallën e mbledhjes në fillim të trajtimit të çështjes së parë.*

#### **RENDI I DITËS:**

*I.* Shqyrtim i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit për një pozicion të lirë” (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Përshëndetje, po fillojmë mbledhjen plenare të datës 24 maj. Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot janë 13 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja nga ana e Këshillit.

Pa humbur kohë le të fillojmë me çështjen e parë, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit për një pozicion të lirë”. Pa humbur kohë ia jap fjalën zotit Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Relacioni në fjalë ka lidhje me përpjekjet që KLGJ po bën për të plotësuar vakancat në nivele të ndryshme të gjyqësorit, në rastin konkret bëhet fjalë për Gjykatën Administrative të Apelit.

Sipas Dekreti të Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, organika e Gjykatës Administrative të Apelit është 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë, numër ky i gjyqtarëve që vijon të jetë ende në fuqi ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka marrë

ende një vendim për numrin e gjyqtarëve për gjykatë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 98/2016.

Në formë tabelare është dhënë në mënyrë nominative struktura organizative e gjyqtarëve pranë kësaj gjykate, ku evidentohet që kjo strukturë ka 13 gjyqtarë; organika në fakt: 8 gjyqtarë; efektivisht në detyrë: 7 gjyqtarë.

Sa më lart, aktualisht, Gjykata Administrative të Apelit ka gjithsej 7 (shtatë) pozicione të lira, nga të cilat 3 (tre) të përkohshme (duke përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit z. {...}) dhe 4 (katër) të përhershme. Ndërkohë mbahet në konsideratë që për gjyqtaren znj. {...} në rastin hipotetik të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë do të krijoje vakancë të përhershme duke shkuar në 5 numrin e gjyqtarëve.

Aktualisht, Këshilli është në proces plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën Administrative të Apelit nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, të hapur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, procedurë kjo që nuk ka përfunduar ende dhe e vlefshme për dy kandidatë gjyqtare znj. {...} (në pritje të vlerësimit etiko-profesionale në datën e përpilimit të relacionit) dhe z. {...}, (të dy në pritje të përfundimit të procedurave të pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve).

Natyrisht propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në nivel apeli administrativ është kryer duke marrë në konsideratë ekuilibrin midis ngarkesës gjithmonë e në ngritje të trupës gjyqësore, si edhe mundësive organizative të burimeve njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilët kryejnë procedurat e vlerësimit etiko-profesionale të gjyqtarëve për disa procedura ngritjesh në detyrë, koha e kryerjes së tyre, (rezultuar nga eksperiencia aktuale), ecuria jo shumë produktive e aktivitetit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën, e cila kufizon jo vetëm konkurrimin e gjyqtareve me përvojë në fushën administrative duke e shndërruar në një garë nominativë por edhe shndërrimin e pozicioneve të përkohshme në të përhershme me anë të vendimit të formës së prerë, numrit të paketë të gjyqtarëve të cilët gëzojnë kriterin ligjor për të qenë gjyqtar të gjykatës së apelit administrativ, (kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar), si edhe të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar në përputhje me ligjin nr.84/2016.

Ndërkohë, në Gjykatën Administrative të Apelit janë krijuar pozicione të lira, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar.

Ndaj, për pozicion të lirë të krijuar së fundmi (z. {...}) në Gjykatën Administrative të Apelit është vendi për plotësimin e tij nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve për të cilën mund të sigurohet edhe një minimum konkurrimi nga gjyqtaret të cilët plotësojnë kriteret ligjore.

Për këtë mbahet në konsideratë se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka plotësuar kuadrin nënligjor të autorizuar nga ligji, për realizimin e këtij procesi.

Vlen të theksohet se sipas nenit 147, pika 1 e Kushtetutës: “Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndërkohë që sipas neni 147/a, pika 1, germa “a”, të saj: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;...”.

Përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve gjen rregullim në ligjin nr.115/2016, pikërisht në nenin 86, shkronja “c” dhe “ç”, ndërkohë që në shkronjën “ë” të dispozitës së fundit, parashikohet përgjegjësia e Këshillit në lidhje me çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për një pozicion të lirë”, duke vlerësuar ngarkesën e çështjeve, pozicionet e lira të përhershme dhe numrin e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore dhe që mund të konkurrojnë. Numri i gjyqtarëve të kësaj Gjykate dhe stoku i çështjeve të pashqyrtuara pranë saj, referuar tabelës si më poshtë rezulton të jetë: për zonjën {...} 1759, për zotin {...} 3326, për zonjën {...} 3307, për zonjën {...} 3303, për zotin {...} 3311, për zotin {...} 3339, për zonjën {...} 3270. Në total 21 615 çështje.

Kështu që në këtë kuadër është përgatitur edhe projektvendimi ku janë parashikuar hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura; afati i kandidimit; informacioni dhe dokumentacioni i nevojshëm që do t'i bashkëngjitet për t'u

plotësuar kërkesa për këtë kandidaturë, si dhe në thelb procedura e kandidimit.

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Toro për relatimin!

Përpara se ta hedhim në votim, kemi ndonjë diskutim?

Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit zonja Kryetare!

Nisur nga situata shumë emergjente dhe nevojat që paraqet Gjykata Administrative e Apelit, unë do të propozoja që numri i vendeve vakante të ishte katër dhe jo një. Nuk ka më arsye që ne “të bllokojmë” plotësimin e vendeve të gjykatës së apelit administrativ. Janë katër vakanca të lira të përhershme. Mund të shpallen të gjitha dhe të vijojë plotësimi i procedurave. Nuk kam për të shtuar asnjë fjalë tjetër sepse relatori e ka pasqyruar në mënyrë të detajuar të gjithë gjendjen dhe ngarkesën në të cilën ndodhet sot Gjykata e Apelit Administrativ.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Fakti që nga ana e Komisionit është proceduar vetëm me hapjen e një pozicioni është thjesht për të mundësuar një konkurrin sa më të gjerë të të gjithë gjyqtarëve që për fat të keq nuk kanë mbaruar procesin e rivlerësimit kalimtar. Theksojmë që kriteret për të qenë pjesë e kësaj trupe gjyqësore janë të tilla që kufizojnë në maksimum numrin e konkurrimit, duke përfshirë këtu edhe që akoma një pjesë e mirë e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative nuk kanë mbaruar procesin e rivlerësimit kalimtar. Kështu që e konvertojmë këtë proces në një proces nominativ, ku do të shkojnë ata që kanë mbaruar procesin e rivlerësimit kalimtar dhe nuk do të ketë konkurrencë.

Unë jam kundër konkurrimeve pa konkurrencë, sepse në thelb nuk është në përputhje me atë që ligji përcakton për karrierën e gjyqtarit, për mënyrën se si vlerësohet ai dhe se kush evidentohet nga më të mirët, ai meriton të shkojë dhe të ketë karrierë në pjesën e trupës gjyqësore. Kështu që në këtë kuadër, në mungesë të një konkurrence të

tillë, e shikoj pa vend që të hapim vende për të çuar apo për të caktuar persona nominativë të cilëve fati u ka buzëqeshur dhe u ka mbaruar procesin e rivlerësimit kalimtar, duke u hequr një pjesë të mirë të konkurrencës kolegëve të tyre.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, unë e vlerësoj ndryshe nga zoti Toro.

Tashmë, edhe nga procedurat e fundit që ne kemi hapur për apelin e juridiksionit të përgjithshëm, nuk ka aspak një stepje të gjyqtarëve për shkak të procesit të rivlerësimit, përkundrazi, të gjithë gjyqtarët kanë aplikuar, madje ne sot kemi në proces gjyqtarë që kanë aplikuar dhe që nuk e kanë kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar. Nga ana tjetër, gjyqtarët administrativë, shumica e tyre e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar (në shkallë të parë, apo janë në ankimim në apel). Për shkak të kriterëve që kërkon ngritja në detyrë, jo domosdoshmërisht mund të jetë nga gjykata administrative e shkallës së parë, sepse rrethi i personave mund të jetë edhe nga ata që kanë pasur përvoja të mëparshme në gjykimin administrativ, sipas kriterëve që parashikon ligji.

Për të mos u zgjatur mendoj që tashmë nuk jemi më në kushtet e emergjencës apo për të respektuar atë që Albani thotë, procedurën e konkurrimit të drejtë dhe të barabartë, dhe që të fillojmë prapë me hapjen e një pozicioni. Kemi katër pozicione të lira të përhershme, mund t'i hapim të katër pozicionet.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

E do njeri fjalën?

Nëse jo, atëherë, sipas procedurës hedhim në votim propozimin e zonjës Ukperaj, e cila sugjeron, nga një pozicion në katër pozicione, dhe më pas kalojmë në propozimin e relatorit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord, me arsyetimin që ngarkesa në apelin administrativ është shumë më e madhe se e apelit civil dhe ne i kemi shpallur atje tre vende. Të paktën për analogji duhet të kishim shpallur edhe këtu (atje është 1700, këtu është 3000 çështje). Kështu që besoj që është shumë e domosdoshme t'i shpallim të gjitha.

**Marçela Shehu:** Jam kundër, duke respektuar edhe standardin që ka mbajtur Këshilli nga momenti që është pozituar e deri tani, ku shpallja e vendeve vakante ka qenë graduale, duke ndjekur edhe ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar. Jam kundër propozimit.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit për katër pozicione të lira.

Për afatin e kandidimit, relatori ka ndonjë propozim?

**Alban Toro:** Në përgjithësi kemi lënë 3-4 javë, me idenë që mbaron ndokush procesin e rivlerësimit kalimtar. Një kohë e mjaftueshme do të ishte e sugjerueshme.

**Naureda Llagami:** Atëherë, 14 qershor.

Atëherë, afati i kandidimit është deri më 14 qershor 2023.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm, për tre pozicione në fushën e të drejtës civile” (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)



Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 6. Valbona Bala, eksperte (EËMI - INL).**
- 7. Përfaqësues të OPDAT-it.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtim i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm, për tre pozicione në fushën e të drejtës civile” (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm, për tre pozicione në fushën e të drejtës civile”, sërish relator është zoti Toro.

*Alban Toro:* Është e njëjta metodologji që është ndjekur për plotësimin e vendeve vakantë në nivele të ndryshme të gjyqësorit. Aktualisht po bëhet ose propozohet për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Sipas vendimit nr. 553, datë 29.12.2022 të Këshilli i Lartë Gjyqësor për caktimin e numrin e gjyqtarëve për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mbështetur në nenet 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja ‘ë’, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 14, 15 dhe 22, të ligjit nr. 98/2016, nenin 2, pika 1 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 505, datë 21.11.2022, ju propozohet nisja e procedurës për hapjen e tre pozicioneve të lira në fushën e të drejtës civile.

Aktualisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm referuar organikës së përditësuar paraqitet sipas tabelës bashkëlidhur këtij relacioni: struktura organizative: 78 gjyqtarë; organika në fakt: 37 gjyqtarë; efektivisht në detyrë: 24 gjyqtarë.

Nga kjo rezulton që Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka gjithsej 54 pozicione të lira, nga të cila 13 (trembëdhjetë) të përkohshme (duke përfshirë anëtarët e KLGJ z. Hado dhe znj. Ukperaj) dhe 41 (dyzet e një) të përhershme.

Natyrisht hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në nivel apeli është propozuar për t'u kryer duke marrë në konsideratë ekuilibrin midis ngarkesës gjithmonë e në ngritje të trupës gjyqësore në nivel apeli si edhe mundësive organizative të burimeve njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilët kryejnë procedurat e vlerësimit etiko-profesionale të gjyqtareve, koha e kryerjes së tyre, ecuria jo shumë produktive e aktivitetit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën, e cila kufizon jo vetëm konkurrimin e gjyqtareve duke e shndërruar në një garë nominative, por edhe shndërrimin e pozicioneve të përkohshme në të përhershme me anë të vendimit të formës së prerë.

Natyrisht në vijim të ndryshimeve lidhur me ristrukturimin e gjykatave të apelit u përfshinë dhe pozicionet e lira të hapura të gjykatave të Apelit Korçë, Vlorë dhe Durrës të filluara më parë. Aktualisht janë ende në proces dhe 8 (tetë) procedura, konkretisht 6 (gjashtë) procedura në fushën penale dhe 2 (dy) në fushën civile.

Nisur nga sa sipër, mund të mendohet se në një kohë jo të largët, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të plotësohet edhe me 8 (tetë) gjyqtarë, duke arritur kështu numri i gjyqtarëve të saj në detyrë në 32 (tridhjetë e dy) ose pak më shumë se 50% e numrit të përgjithshëm të tyre.

Siç kemi thënë më lart, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka gjithsej 41 (dyzet e një) pozicione të lira të përhershme, ku për plotësimin e 8 (tetë) prej të cilave janë në proces procedurat përkatëse të ngritjes në detyrë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, sikurse edhe më parë, konsideruar edhe nga Këshilli, vlerëson se ato duhet të plotësohen përmes hapjeve graduale e të vazhdueshme të procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve duke synuar një konkurrim sa më të gjerë në rekrutimin dhe emërimin e tyre.

Lidhur me nevojën e hapjes së 3 (tre) procedurave të ngritjes në detyrë në

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, përveç situatës aktuale, nivelit të lartë të numrit çështjeve që kjo gjykatë gjykon (dhe që është më e madhe se gjykata e apelit administrativ), vlerësoi se fillimi aktualisht i tre procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke mbajtur parasysh dhe kohën relativisht të gjatë që këto procedura kanë marrë deri më sot, më së paku 6 (gjashtë) muaj, do të mundësonte plotësimin e 3 (tre) pozicioneve të lira në një kohë më të shpejtë, duke përmirësuar në këtë mënyrë sado pak funksionalitetin dhe ulur ngarkesën e saj. Ndërkohë aktualisht stoku i çështjeve për gjykim përpara kësaj gjykate aktualisht, më datë 02.05.2023 është 34.895 çështje, ngarkesë që jo vetëm rezulton të jetë vrastare për trupën gjyqësore, por ka efekte negative pasi dëmton të drejtën e gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm.

Në këto kushte KZHK-ja ka përgatitur projektvendimin përkatës ku natyrisht është përcaktuar momenti i hapjes dhe i shpalljes së kërkesës për kandidatura, afatin kur mbyllet ky kandidim; informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet për t'iu bashkëlidhur kandidimit, si dhe procedurën e kandidimit.

Ky është pak a shumë projektvendimi dhe relacioni i cili shoqëron këtë projektvendim, për nevojën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Përpara se të kalojmë në votim, ndonjë diskutim?

Po!

**Marçela Shehu:** Atëherë, zoti Toro, për sqarim. Sa vende të tjera të lira mbeten pa u shpallur në Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm?

Janë 54 vende vakante.

**Alban Toro:** Janë 54 por pritet që 8 janë në vijim. Shpresojmë t'i mbarojmë.

**Marçela Shehu:** Procedurat po ecin.

Që i bie që janë edhe 46.

**Brikena Ukperaj:** 41 ke nxjerrë vakanca.

**Marçela Shehu:** Me standardin që vendosëm, pra kishim katër vende vakante në apelin administrativ, i shpallëm të katra. Kur Gjykata e Apelit të Përgjithshëm ka kaq nevojë, atëherë nga 41, të paktën të shpallim 30. Meqë Këshilli e mbajti këtë standard.

**Yllka Rupa:** A ka kapacitete?

**Marçela Shehu:** Ne nuk mund të ecim me kapacitete.

Ne i kemi mbajtur dhe i kemi bërë shpalljet graduale, për t'i dhënë mundësi të gjithë gjyqtarëve që të hyjnë në garë. Tani thamë, shumica e kanë kaluar, nuk kemi pse të presim më. Nga 4 vakanca që kishte apeli administrativ, i shpallëm. 41 janë shumë. Kapacitetet do t'i gjejmë rrugës.

Nga 41, 30 vende vakante.

**Naureda Llagami:** Diskutim tjetër?

Po!

**Brikena Ukperaj:** Propozimi im për katër vendet e apelit administrativ ishte sepse ngarkesa është e jashtëzakonshme në Gjykatën e Apelit Administrativ, ku kanë mbi 3000 çështje një gjyqtar. Nuk e kemi këtë ngarkesë çështjesh në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

*(Zonja Shehu dhe zonja Ukperaj flasin njëherësh.)*

**Brikena Ukperaj:** Këtë merak nuk e kishe për apelin administrativ, e ke për apelin e juridiksionit të përgjithshëm.

**Marçela Shehu:** Sepse deri tani respektova standardin që Këshilli ka vendosur që në 2019, që t'i japim mundësi të gjithë gjyqtarëve që kalojnë procesin e rivlerësimit.

**Brikena Ukperaj:** Të lutem zonja Shehu, unë nuk të ndërpreva.

Të lutem, nuk të ndërpreva. Të dëgjova, të respektova në fjalën tënde. Do ta votoj propozimin. Tani kam propozimin tim. Nuk ka pse të kesh këto tone të ashpra, të larta të zërit.

Propozimi im për apelin e juridiksionit të përgjithshëm –

Albani na ka nxjerrë aktualisht 41 vakanca të lira të përhershme.

Këto 41 vakanca të lira të përhershme ne kemi 7 procedura apo 8 procedura në proces. 41, heqim 8 procedura, kemi 33 vakanca të lira të përhershme në apelin e juridiksionit të përgjithshëm. Atëherë, në vlerësimin tim, për të shkuar në proporcion me shpërndarjen e barabartë të ngarkesës së gjyqtarëve dhe për të menaxhuar më mirë procesin, nëse apeli administrativ paraqet një situatë emergjente, sepse çështjet nuk po gjykohen, nuk është në të njëjtën situatë si apeli i juridiksionit të përgjithshëm, unë do të propozoja që jo tre, por të paktën të çojmë 6 gjyqtarë, të hapim vende vakante për 6 gjyqtarë, me qëllim që të çojmë të paktën edhe dy trupa të tjerë civilë.

Nuk kemi sot asnjë studim, që të çojmë në 30 vende, se sa civile, sa penale. Si do shpërndahen? Sot me këtë relacion ne nuk e dimë. Vërtetë hapim 30, por sa do jenë civile dhe sa do jenë penale në këto 30?

Hapja e më shumë se 10 vendeve kërkon një studim të mirëfilltë, të paktën për fushën e së drejtës që do hapim pozicionet. Për shkak të ngarkesës dyfishe që ka sot dhoma civile, jo tre gjyqtarë, por duke marrë parasysh edhe qëndrimin në Gjykatën e Apelit Administrativ, do të propozoja 6 gjyqtarë, pra 6 vakanca.

**Marçela Shehu:** Mundem?

**Naureda Llagami:** Po!

**Marçela Shehu:** Në qoftë se është çështje e mundësive, nuk besoj se Këshilli nuk i ka mundësitë që t'i hapi procedurat, t'i vijojë procedurat dhe t'i mbyllë procedurat edhe për 30 vende të shpallura.

Në lidhje me studimin, besoj që ju e para zonja Ukperaj, e keni të qartë numrin e çështjeve civile që janë në gjykim në Gjykatën e Apelit, duke qenë se edhe jeni kryetare e Komisionit të Vlerësimit Profesional. Kështu që nuk besoj se është çështje statistikash. Nëse është çështje statistikash, ne marrim kohë, mund ta ndërpresim mbledhjen, e bëjmë

diskutim pak më vonë dhe diskutojmë të gjithë së bashku, dhe dakordësojmë sa duhen në penale, sa dhen në civile. Në qoftë se është kjo pengesa. Por për të ruajtur standardin që ne vendosëm, ku ka vende të lira, mendoj që duhet të shpallen. Nuk kemi më pse t'i mbajmë. Nuk kemi asnjë pengesë. Këshilli e vendosi standardin që t'i shpallim, tani le t'i shpallim të gjitha vendet. Nëse na duhet kohë të shikojmë numrin e vendeve, ia kërkojmë drejtorisë përkatëse dhe vendosim sa do hapim civile dhe sa do hapim penale.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Marçela Shehu:** Jo, jo. Çfarë, do presim që të bëjë 7 vjetëshin?

Do presim që të plotësojnë 7 vjetëshin këta që kanë 5 vjet?

S'është kjo analiza. Zonja Ukperaj me të drejtë tha, ne nuk e dimë sa çështje civile ka dhe sa çështje penale ka, që ne të vlerësojmë sa vende do hapim në fushën penale dhe sa vende në fushën civile. Që këtë ne e gjejmë për 10 minuta. Nuk ka nevojë shumë për studim.

Ndërsa që të presim që të bëjnë gjyqtarët 7 vjet punë, s'më duket arsye për të mos shpallur procedura, se i bie që ne po presim ca njerëz që të plotësojnë kriteret ligjore.

**Alban Toro:** Mund të shtoj edhe unë?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Për të qenë të saktë për ngarkesën e dy gjykatave, se shtuam një paralele sikur ishin të ndryshme ngarkesat në të dy gjykatat. Mos të harrojmë një Gjykata Administrative ka 21 615 çështje. Ajo e apelit ka 34 895 çështje.

**Brikena Ukperaj:** Ngarkesa për gjyqtar Alban. Jo ngarkesa e gjykatës.

**Alban Toro:** Ta mbarojmë pak ngarkesën totale?

Dhe jeni ju që keni evidentuar punë të dobët të kryerjes së konflikteve gjyqësore nga gjykata administrative dhe i keni vlerësuar dhe i keni pasqyruar këto vlerësime sepse të paktën për vitin që shkoi ata kanë bërë pak çështje. Aq çështje sa ka bërë në muaj

grykata e apelit e Tiranës, kanë bërë këta.

Në lidhje pastaj me studimin, a duhen civile apo penale, ju e keni parë shumë mirë që ato vendimet tuaja nuk i kanë hyrë në punë askujt sepse Këshilli i Gjykatës ka vepruar për qejf të vet, s'ka respektuar se ku e ke hapur pozicionin; s'ka respektuar konkurrimin që kanë bërë gjyqtarët; dhe ata që s'kanë konkurruar sepse s'plotësonin kriterin e pozicionit që ishte hapur; për këtë pjesë nuk e keni vënë ujin në zjarr, kështu që nuk besoj se do ndonjë studim, sepse ia lëmë në dorë Këshillit të Gjykatës ta plotësojë si ta ketë dëshirën, t'i çojë trupat gjyqësore si t'i dojë. Por ideja është të ruajmë standardin. Në qoftë se themi që standardi i kahershëm i këtij Këshilli ka qenë që të bëjë në mënyrë të kujdesshme, në mënyrë që t'i jepet kohë të gjithë trupës gjyqësore të konkurronte në një bazë sa më të gjerë dhe jo me emra nominativë. Kështu është vepruar nga fillimi i këtij Këshilli deri në këtë moment që po flasim. Sot papritmas ndryshon projeksioni, na përfshihet një numër edhe pse nuk është bërë ndonjë analizë se ku do t'i marrim. Ndoshta për ato tre vende do konkurrojnë tre vetë. Nëse është ky konkurrim, ok, vazhdoni ndryshoni standardet sepse për mua ky është ndryshim standardi. Shkojmë pastaj tek ajo që edhe 30 edhe 40, për mua s'ka problem, le t'i hapim.

**Brikena Ukperaj:** Alban të lutem, nuk është hera e parë që ne po hapim katër pozicione.

**Alban Toro:** Jo, jo, s'ka lidhje me katër pozicionet.

**Brikena Ukperaj:** Po diskutojmë për apelin administrativ.

**Alban Toro:** Çështja është ku do t'i gjejmë që të konkurrojnë.

**Brikena Ukperaj:** Ne kemi hapur 7 dhe 8 pozicione kur ka qenë për apelin e juridiksionit të përgjithshëm, në penale dhe në civile. Nuk u hap për herë të parë katër pozicione. Përkundrazi, në minorancë kanë qenë rastet kur u hapën 1 apo 2 pozicione. E dyta, ke ndonjë informacion ti sa për qind e gjyqtarëve nuk e kanë kaluar vetting-un? Sa është përqindja e gjyqtarëve? Sepse janë shumë pak gjyqtarë që nuk e kanë kaluar

procesin e rivlerësimit kalimtar.

**Alban Toro:** E ndërpresim dhe e marrim direkt statistikën.

**Brikena Ukperaj:** Po dua të them që nuk është pengesë procesi i rivlerësimit.

**Alban Toro:** Aktualisht më rezulton që ti e paske bërë këtë studim sepse po pretendon ngritje numri, që do të thotë, kur ju pretendoni që të ngrihet numri, do të thotë që paskeni një bazë konkurrence shumë të madhe, sepse e paskan kaluar disa veta. Na e thoni këtë numër.

**Brikena Ukperaj:** Alban, unë nuk po them 30, por po them 6.

**Alban Toro:** Edhe 6 janë shumë.

**Brikena Ukperaj:** Edhe diçka tjetër, vështirësia që po na shkaktohet nga grumbullimi i një numri shumë të madh kandidatësh për një pozicion, duke hapur tre pozicione, ne na vijnë mbi 10 gjyqtarë në një pozicion dhe duhet që për të 10 gjyqtarët të bëhen vlerësime dhe duhet të presin njëri-tjetrin. Kur hapim më shumë pozicione ata shpërndahen nëpër pozicione dhe kështu ka më shumë mundësi që të mbarojnë vlerësimet për një pozicion. Edhe për këtë shkak.

**Alban Toro:** Unë nuk mendoj se po shkon tek frekuenca që po përdor Marçela, që të hapim 30.

**Brikena Ukperaj:** Nuk shkoj në 30.

**Alban Toro:** Pra hapim 30 vende, do ketë nga 2 kandidatë dhe mbarojmë më shpejt. Ky është thelbi.

**Brikena Ukperaj:** 30 është shumë. Për momentin nuk e vlerësoj dhe unë.



**Alban Toro:** Mentaliteti është njësoj. Logjika matematikore e përdorur është njësoj. Hapim sa më shumë, që të ketë sa më pak konkurrentë për çdo pozicion dhe ne ecim sa më shpejt.

Këtu nuk e shikoj problemin tek hapja e vendeve. Ti bllokohesh tek vlerësimi etiko-profesional.

**Brikena Ukperaj:** Janë disa faktorë të cilët ndikojnë në hapjen e sa më shumë procedurave. Nuk po them 30, që të kemi edhe ne mundësi të menaxhojmë plotësimin e vakancave, se nuk është njësoj të hapësh 6 e 4 dhe të hapësh 30 pozicione. Nuk është njësoj. Nuk është njësoj, se nuk i menaxhojmë dot. Nuk e dimë a kemi edhe burime njerëzore në apel për 30 vakanca në fakt. Unë vazhdoj i qëndroj për 6.

**Fatmira Luli:** Unë mendoj që ndoshta është më mirë të shpallim 10 për apelin, për shkak se edhe 8 janë në proces dhe 10 i shpallim ne, bëhen 18. Kjo edhe për efekt të ambienteve të gjykatës që nuk ka shumë vende për të gjithë, derisa të ketë një zgjidhje për hapësirën e gjykatës së apelit.

**Alban Toro:** Aty nuk ka edhe për këto aktualet. Për ta ditur.

**Ridvan Hado:** Unë jam dakord me parimin që vakancat e përhershme të plotësohen, kështu që jam dakord me propozimin e Marçelës.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi tre propozime: Kemi 6 vende që argumenton Brikena, duke argumentuar krijimin e 2 trupave; Kemi propozimin e Marçelës, i cili thotë 30 vende.

**Brikena Ukperaj:** Në 9. Në civile. (*Propozimi i zonjës Luli dhe zonjës Ukperaj bashkohen për shpalljen e 9 pozicioneve, pra tre trupa gjykues.*)

**Naureda Llagami:** Në 9. Në tre trupa gjykues, në civile. Kemi dhe propozimin e

Marçelës që shkon në hapjen e të gjithë vendeve vakante.

Pra kemi gjithsej dy propozime. Në qoftë se Brikena bashkohet me Fatmirën, për 9, dhe Marçela, për të gjithë vendet vakante.

**Marçela Shehu:** Për propozimin që bëra unë, më duhet vlerësimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, sepse nuk e kam informacionin tani se sa gjyqtarë ka në seksionin penal, sa në seksionin civil dhe sa është backlog-u i çështjeve penale, civile, dhe sa është trendi, që unë të bëj mbase edhe propozimin sa pozicione në fushën penale dhe sa pozicione në fushën civile.

**Alban Toro:** Atëherë, është e sigurt, por të saktë nuk e kam (ta ndërpresim, që të shkoj ta marrë), ngarkesa civile është shumë më e madhe dhe jo pa qëllim ne në çdo hapje që kemi bërë kemi tentuar gjithmonë të hapim më shumë pozicione civile. Fatkeqësisht kjo nuk ka qenë frekuenca që ka përdorur Këshilli i Gjykatës, kështu që them, do të na ndodhi e njëjta histori, ne hapim civile, ata çojnë në penale. Kështu që, nëse do ju duhet e saktë, atëherë më duhet ta ndërpres, të marrë ngarkesën e saktë në civile dhe në penale, dhe shpërndarjen e trupave gjyqësore si në civile dhe në penale. Por do më duhet kohë.

**Brikena Ukperaj:** Megjithatë Kryetare, ne mund ta hedhim në votim propozimin e Marçelës për të hapur të gjitha vakancat. Nëse ai kalon në Këshill, atëherë marrim kohë për të ndarë sa në civile dhe sa në penale.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në propozimin e parë për hapjen e të gjithë vendeve vakante (propozimi i zonjës Shehu).

**Ilir Rusi:** Kundër.

**Irena Plaku:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Klodian Kurushi:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

*(Nuk miratohet propozimi i zonjës Shehu.)*

**Naureda Llagami:** Hedhim në votim propozimin e zonjës Ukperaj së bashku me zonjën Luli, për 9 vende vakante, në fushën e së drejtës civile.

**Illir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ridvan Hado:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Logjikisht jam dakord sepse kërkova që të shpallen 30. Nuk u shpallën 30, hapen 9, me shpresën që mbase Këshilli reflekton dhe në mbledhjet e tjera i shpallim edhe ato të tjerat.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet me shumicë votash propozimi i zonjës Ukperaj dhe znj. Luli.)*

Atëherë, Këshilli vendosi hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për 9 (nëntë) pozicione të lira, në fushën e së drejtës civile, me afat kandidimi sërish 14 qershor 2023.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

3.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

3.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

3.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

3.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.

3.6 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.7 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.8 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për

kandidatura.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 10. Brikena Ukperaj*** (anëtare)
- 11. Yllka Rupa*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.***
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.***
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.***
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).***
- 7. Përfaqësues të OPDAT-it.***

## **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

3.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

3.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

3.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

3.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

3.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.

3.6 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.7 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

3.8 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, që kanë të bëjnë me hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale. Gjithashtu hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Për hapjen e

procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative. Më tej hapjen e procedurave të transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për më shumë detaje fjalën ia japim zotit Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 147 të Kushtetutës ka përgjegjësi jo vetëm për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por ka përgjegjësi për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, kjo e fundit tregues i qartë i vëmendjes që Këshilli duhet të tregojë në raport me statusin e gjyqtarëve dhe zhvillimit të karrierës së tyre. Më tej, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, e ka përcaktuar Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin më të lartë përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe në mënyrë të veçantë, ka parashikuar procedura të veçanta kur konstaton pozicione të lira, pas çdo kontrolli tremujor të kryer me qëllim konstatimin e vakancave të përhershme të përkohshme. Për më tepër në nenin 89, pika b, të këtij ligji të përmendur më lart, Këshilli ka detyrimin të monitorojë dhe kontrollojë ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve me qëllim përmirësimin e produktivitetit të tyre në mënyrë që parimi “gjykimi brenda një afati të arsyeshëm” të mos konvertohet në “drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar”.

Për shkak të: i) aplikimit të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ii) si edhe detyrimeve që ka Këshilli në zbatim të legjislacionit në fuqi përmes mekanizmit të komandimit të gjyqtarëve, që shërbejnë në pozicione të caktuara në institucionet e sistemit të drejtësisë për periudha afatgjata, deri në 5 apo edhe 10 vjet, trupat gjyqësore të të gjitha niveleve të gjykatave në Republikën e Shqipërisë kanë pësuar ulje të ndjeshme duke krijuar vakanca të përhershme e të përkohshme në mënyrë sistematike.

Një nga këto gjykata, ku së fundmi pasqyrohet në përpjesëtim të zhdrejtë, rritja e numrit të konflikteve gjyqësore dhe pakësimi i numrit të trupës gjyqësore, duke shkaktuar

një rritje të ndjeshme dhe të papërballueshme të ngarkesës së trupës gjyqësore dhe cenuar në këtë mënyrë funksionalitetin e saj, është edhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me gjithë masat e marra nga Këshilli, ku në korrik 2022 u caktuan në pozicion 3 (tre) gjyqtarë në këtë gjykatë.

Sipas vendimit të Këshillit nr.146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm” është përcaktuar se organika në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan do të jetë 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Aktualisht, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan referuar organikës së përditësuar të datës 02.05.2023 vijon si më poshtë: Struktura Organizative: 18 gjyqtarë; Organika në fakt: 12 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë: 5 gjyqtarë. (tabela bashkëlidhur në relacion).

Sa më lart, aktualisht, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka gjithsej 6 (gjashtë) pozicione të lira të përhershme dhe 7 (shtatë) pozicione të lira të përkohshme, referuar kjo tabelës si më poshtë të përditësuar pas vendimeve nr. 146/2023 dhe 214/2023 të Këshillit: Struktura organizative 18 gjyqtarë, Organika në fakt 12 gjyqtarë, efektivisht në detyrë 5 gjyqtarë, Vakanca të përhershme 6, Vakanca të përkohshme 7.

Vlen të përmendet se, në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan – gjykatë, e cila siç u përmend në organikë nga 18 ka vetëm 5 gjyqtarë efektivë, ka një ngarkesë sipas tabelës së mëposhtme. Ngarkesa është e ndarë në çështje civile, çështje penale. Afërsisht në tabelë shkojnë rreth 800, 400, 800, 800, 590, 865, pra ngarkesa është mbi 500.

Aktualisht, ngarkesa e gjyqtarëve në këtë gjykatë varion minimalisht për gjyqtarë, nga 590 çështje në maksimalisht në 865 çështje për gjyqtar, ndërkohë nga kjo gjykatë për vitin 2022 e janë paraqitur 2 kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme. Parashikimi, duke u mbështetur në historikun dhe përvojën e deritanishme në lidhje me stabilizimin e situatës nuk na rezulton që është optimist.

E njëjta situatë e ngarkuar dhe jo optimiste vlen edhe për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për të cilën janë administruar të dhënat e



mëposhtme.

Situata aktuale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë:

Sipas vendimit nr.146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm” është përcaktuar se organika në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë do të jetë 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Aktualisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë referuar organikës së përditësuar, vijon si më poshtë: Struktura Organizative: 11 gjyqtarë; Organika në fakt: 9 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë: 6 gjyqtarë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka gjithsej 2 (dy) pozicione të lira të përhershme dhe 3 (tre) pozicione të lira të përkohshme referuar kjo tabelës që është inkorporuar në këtë relacion.

Ngarkesa e gjyqtarëve në këtë gjykatë varion minimalisht për gjyqtarë, nga 265 çështje në maksimalisht në 324 çështje për gjyqtar. Ndërkohë nga kjo gjykatë janë paraqitur për periudhën janar 2022 e në vijim, 38 kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme nga të cilat janë plotësuar me 44 gjyqtarë. Parashikimi, duke u mbështetur në historikun dhe përvojën e deritanishme në lidhje me stabilizimin e situatës edhe në këtë gjykatë, pavarësisht riorganizimit të bërë, duke përfshirë edhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, nuk është optimist.

Më poshtë ngarkesat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin deri më datë 30.03.2023, janë paraqitur në tabelat përkatëse dhe variojnë më e larta 324 për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë (ngarkesa e numrit të çështjeve që shqyrton kjo gjykatë). Nuk janë të ndara seksionet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Të gjithë gjyqtarët gjykojnë si çështje civile edhe çështje penale. Para riorganizimit të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Lezhë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, numri më i lartë i çështjeve për gjyqtar ishte 207.

Situata aktuale në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë:

Sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë është 16

(gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë, numër ky i gjyqtarëve që vijon të jetë ende në fuqi, ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të marrë një vendim për numrin e gjyqtarëve për këtë gjykatë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sikurse kjo përcaktohet në nenin 90 të tij.

Aktualisht, në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë referuar organikës së përditësuar, vijon si më poshtë: Struktura Organizative: 16 gjyqtarë; Organika në fakt: 13 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë: 11 gjyqtarë.

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë ka gjithsej 5 (pesë) pozicione të lira, nga të cilat 2 (dy) të përkohshëm dhe 3 (tre) të përhershëm, referuar kjo tabelës si më poshtë përcjellë nga Zyra e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së.

Vlen të përmendet se në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë aktualisht janë në detyrë 11 gjyqtarë, nga 16 të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Ndërkohë nga kjo gjykatë janë paraqitur për periudhën janar 2022 e në vijim, 24 kërkesa për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme nga të cilat janë plotësuar me 24 gjyqtarë. Aktualisht ngarkesa e çështjeve gjyqësore për gjyqtar, paraqitet si më poshtë. Ngarkesa është e tillë, ku numri më i lartë i çështjeve për një gjyqtar, 413 çështje në dorë, ndërsa më i ulëti është 115 çështje në dorë.

Mekanizmat ligjorë për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme e atyre të përkohshme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

Me qëllim që të stabilizohet dhe të parandalohet cenimi i mëtejshëm i funksionalitetit të këtyre gjykatave duke përfshirë edhe efektet që rrjedhin nga aplikimi i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vazhdimi i krijimit të vakancave të tjera të përkohshme dhe të përhershme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar që t’i propozojë Këshillit, mjetet efikase dhe ligjore që do të mund të stabilizojnë funksionalitetin, tashmë të cenuar të këtyre gjykatave.

Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, është vlerësuar dhe do të propozohet një zgjidhje afatgjatë, që do të kërkojë disa kohë për mbarimin e saj,

pasi interferohet me procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve dhe nuk do të mund të konsiderohet si mjete më efikas i stabilizimit të funksionalitetit të gjykatave. Sjell në vëmendjen tuaj parashikimet e nenit 43 të cilat trajtojnë procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve.

Qëllimi i nenit 43 është të garantojë zhvillimin e procesit të lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, duke parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për të zhvilluar karrierën e tij. Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të njëjtit nivel.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar të vlerësojë, periodikisht ose rast pas rasti, nevojën për plotësimin e vendeve të lira në gjykata duke respektuar kushtet dhe parimet të parashikuara në nenin 42 lidhur me transferimin e magjistratit si dhe të rregullave të hollësishme që parashikon neni 43 për lëvizjen paralele. Gjithashtu magjistratët i nënshtrohen së pari renditjes së preferencës, parashikuar nga neni 42, pika 3 e Ligjit Për Statusin dhe rregullave lejuese e ndaluese që parashikohen në nenin 43, me qëllim plotësimin e vendeve të lira sipas një renditjeje të caktuar.

Qëllimi i nenit 42 është të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magjistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm sipas nevojave të sistemit të drejtësisë, por edhe në respektim të funksionit të magjistratit. Duke vendosur disa parime bazë, mbi të cilat kryhet transferimi, ligjvënësi synon së pari të disiplinojë këshillat në vendimmarrjen që lidhen me transferimin në pozicione të përhershme ose të përkohshme të magjistratëve sipas rregullave të parashikuara specifikisht dhe procedurave të ndërmarra për këtë qëllim. Së dyti, ai synon të ofrojë siguri, qartësi dhe parashikueshmëri për magjistratin, i cili mund t'i nënshtrohet procedurës së lëvizjes paralele.

Më tej, pika 3 parashikon rrethanat dhe kategoria e magjistratëve që caktohen në një pozicion të lirë të përhershëm, konkretisht:

- a) nga magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;
- b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose

për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive.

Në pikat 3 dhe 4 jepen kategoritë e magjistratëve, sipas radhës, që kanë të drejtë të transferohen në pozicionet e përkohshme dhe të përhershme, që përfshihen:

- a) magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;
- b) magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimit të strukturës administrative;
- c) magjistrati që transferohet sipas lëvizjes paralele;
- ç) magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë (pika 3).

Për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme Këshilli është i detyruar të respektojë radhën sipas shkronjave të mësipërme a); b); c) dhe ç). Në kushtet kur Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë, dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë janë gjykata të shkallës së parë, procedura e ngritjes në detyrë në këto gjykata nuk mund të aplikohet. Pozicionet e lira të përhershme në këto gjykata mund të plotësohen si rregull vetëm nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në rast se nuk ka magjistratë që duhet të transferohen pranë këtyre gjykatave sipas parashikimeve të shkronjave a) dhe b). Pas verifikimeve të kryera, ka rezultuar se aktualisht, Këshilli nuk ka detyrimin ligjor për të transferuar gjyqtarë sipas pikës a) dhe sipas b), në kushtet kur nuk rezulton të këtë gjyqtarë që “kanë të drejtë të caktohen në nivel apeli” apo “gjyqtarë që duhet të transferohen për shkak të papajtueshmërisë ambientale” apo ndryshimit të strukturës administrative.

Pas kësaj faze, Komisioni, duke marrë në konsideratë situatën e pasqyruar më lart, në të cilën ndodhemi sot, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, do t'i propozojë Këshillit të shpallë hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 3 pozicione të lira të përhershme, nga të cilat 2 (dy) në fushën e së drejtës civile dhe 1 (një) pozicion në fushën e së drejtës penale, marrë në konsideratë ngarkesën e konsiderueshme të dhomës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan; 1 pozicion i lirë i përhershëm në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhe 1 pozicion i lirë të përhershëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në përputhje me nenin 43 e vijues të ligjit “Për statusin” dhe vendimin nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe

procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”.

Më tej, Komisioni duke vlerësuar se procedurat e lëvizjes paralele do të kërkojnë një kohë të caktuar, pasi janë të ndërlydhura dhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që do të kandidojnë, propozon që njëkohësisht me hapjen e procedurave të lëvizjeve paralele të fillojnë edhe procedurat e transferimit të përkohshëm të parashikuar nga neni 46 i Ligjit për Statusin, si një nga instrumentet më të shpejtë në kohë, që mund të stabilizojë funksionalitetin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan klasifikohet si “gjykatë në nevojë”, në kuptim të shkronjës “a”, pika 2, neni 3, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, miratuar me vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite: “... a) “Gjykatë në nevojë” nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj”.

Në situatën që ndodhet kjo gjykatë, Komisioni vlerëson se adresimi më i shpejtë në kohë i nevojave të saj mund të bëhet përmes transferimit të përkohshëm të gjyqtarit me pëlqimin e tij.

Sa i përket hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në rastin konkret, Komisioni vlerëson se ekzistojnë dy kushtet që e lejojnë atë, përcaktuar ato në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr. 96/2016, sikundër edhe në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm.

Duke ardhur në rastin konkret, konstatohet se në skemën e delegimit (pra referuar skemave që do duhet të përdoren përpara sesa ne të propozojmë transferimin e përkohshëm) nuk ka magjistratë të disponueshëm, pasi 3 nga 4 gjyqtarët e caktuar tashmë në skemën e delegimit, për shkak të nevojave imediate në pikëpamje të funksionalitetit të gjykatës së posaçme të shkallës së parë, janë caktuar për të gjykuar për një periudhë 1-vjeçare pranë kësaj gjykate, duke përmendur z. {...} i cili është caktuar në skemë delegimi për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit; znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, janë caktuar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, konkludojmë që nevojat

e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për sa kohë ato janë imediate, nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit.

Vlen të përmendet se nevojat Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk mund të adresohen as nëpërmjet masave të tjera, sikurse janë ato sipas vendimit të Këshillit nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, pasi sipas këtij vendimi, mundësohet caktimi i gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta vetëm në kushtet e padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarëve të asaj gjykate për gjykimin e tyre. Në rastin konkret nevoja është për gjykimin në vijimësi të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pra për një periudhë të caktuar kohe dhe jo për çështje gjyqësore të veçanta. Lidhur me këtë moment mbahet parasysh rregullimi i pikës 2, të nenit 5, të Rregullores së përmendur më lart, të transferimit të përkohshëm.

Ndaj sa sipër, Komisioni vlerëson se për plotësimin e nevojave që paraqet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Këshilli duhet të orientohet paralelisht edhe në përcaktimet e Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, duke hapur kryesisht procedurën e transferimit të përkohshëm në pozicionet e lira të përkohshme pranë kësaj gjykate, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 5, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm.

Në këtë optike Komisioni propozon hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për 3 pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Pra këto janë propozimet tona:

1. Fillimin e procedurave për lëvizje paralele për 2 (dy) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile dhe 1 (një) pozicion të lirë të përhershëm në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për 1 (një) pozicion të lirë të përhershëm në fushën e së drejtës civile në Gjykatë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe për 1 (një) pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas projektvendimeve që janë përfshirë bashkëlidhur këtij relacioni.

2. Njëkohësisht me fillimin e procedurave të lëvizjes paralele, propozojmë edhe fillimin e procedurave për transferimin e përkohshëm në 3 (tre) pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Afati i kandidimit, çështje që është lënë për t'u diskutuar, meqenëse dy të tjerat janë më datë 14, unë po e propozoj tani paraprakisht edhe datën 14.

Duke ndjekur rregullin, po e propozoj unë datën 14.06.

Nëse kolegët nuk dakordësohen, jam dakord me çfarëdo lloj propozimi që mund të paraqiten nga kolegët e tjerë.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Pra kemi dy pozicione në fushën e së drejtës civile, një pozicion në fushën e së drejtës penale. Një pozicion në Lezhë në fushën e së drejtës civile. Dy pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Një pozicion, më fal (lëvizje paralele). Më pas hapjen e tre pozicioneve për transferim të përkohshëm me pëlqim.

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Po!

**Brikena Ukperaj:** Relacioni dhe projektvendimet që e shoqërojnë atë kanë të bëjnë me gjetjen e mekanizmave ligjorë për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme dhe të përkohshme në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, Lezhë dhe administrative Tiranë.

Në fakt ky është një vendim i cili do të afektojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjetjen e vendeve vakante për kandidatët për magistratë që priten të emërohen në korrik (nëse do të arrijmë që t'i mbyllim vakancat). Pra gjithmonë plotësimi i vendeve vakante në këtë moment, qoftë nëpërmjet mekanizmave, duhet parë si një mekanizëm i Këshillit me qëllim që nëpërmjet lëvizjes paralele ne të krijojmë pozicione të lira të përhershme në gjykata të tjera për emërimin e magistratëve. Unë dakordësohem me propozimin e Komisionit për hapjen e tre pozicioneve të lira për lëvizjet paralele në Elbasan sipas raportit 2:1 (dy civile dhe një penale), por nuk dakordësohem me hapjen e procedurave të transferimit të përkohshëm me pëlqim për tre pozicione, edhe pse ai do të ishte një

mekanizëm i shpejt i mbushjes dhe i plotësimit të nevojave të gjykatës. Sepse, me transferimin e përkohshëm nuk zgjidhim asnjë gjë për sa i përket vakancave të magjistratëve. Sepse me transferimin e përkohshëm, gjyqtarit nuk ia zëmë dot vendin në gjykatën nga vjen dhe njëkohësisht na zë një vend në Elbasan që nuk e përdorim dot as për magjistratët. Pra për një transferim, ne zëmë dy vakanca. Të dyja të përkohshme nuk i përdorim dot për magjistratë. Edhe pse transferimet, praktikisht thuhet që do shkojnë në pozicione të lira të përkohshme, në fakt këto transferime nuk ndodhin në pozicione të lira të përkohshme sepse ai pozicion i lirë i përkohshëm, gjyqtari që është aty merr 75%. Pra transferimi i përkohshëm do të zërë një pozicion të lirë të përhershëm (nuk do ta zërë pozicionin e lirë të përkohshëm).

E dyta, mendoj që me situatën e hartës së re gjyqësore, transferimet e përkohshme duhet të jenë mekanizmi i fundit nëse lëvizja paralele nuk është e mundur. Duke qenë se kemi gjashtë pozicione të lira të përhershme në Elbasan, unë do të propozoja që të gjashta pozicionet të hapeshin për lëvizje paralele dhe asnjë pozicion për transferim të përkohshëm, duke ruajtur raportin që Komisioni ka vlerësuar 1:2, katër pozicione civile dhe dy pozicione penale. Ky është propozimi im për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Për sa i përket Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, jam dakord me propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Nuk kam kundërshtim.

Por vlerësoj që në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të nevojave që do kemi në sistem për plotësimin e vendeve me kandidatët për magjistratë, ka tre vakanca, t'i hapim të treja për lëvizje paralele, nuk ka pse të hapim një. Nëse hapim tre, do të kemi mundësi që të hapim në Gjykatën Administrative Lushnjë tre vende pastaj për magjistratë, me qëllim që t'u japim mundësi edhe këtyre magjistratëve që kanë punuar në rrethe, të afrohen, dhe të hapim edhe tre vende... sepse e dimë që në gjykatën administrative të shkallës së parë lëvizja paralele vjen vetëm nga gjykata administrative, nuk vjen lëvizja paralele nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Me këtë logjikë do të kemi mundësi që të hapim tre vakanca të tjera në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Gjithsesi kjo është për ta vlerësuar Këshilli.

Këto ishin dy propozimet e mia. Pra tre vakanca t'i hapim për lëvizje paralele në



administrativen e shkallës së parë Tiranë dhe gjashtë lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Jo transferime të përkohshme.

**Naureda Llagami:** Keni ndonjë diskutim tjetër?

**Marçela Shehu:** Për zotin Kurushi.

Në Elbasan ka gjashtë vende të lira të përhershme?

(Konfirmohet nga zoti Kurushi që janë gjashtë vende të lira.)

Janë!

Mirë, unë i qëndroj propozimit që bëra me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të shpallen të gjitha pozicionet e lira të përhershme për lëvizje paralele në të gjitha gjykatat, si në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, si në Lezhë, si në Elbasan.

**Ridvan Hado:** I njëjti argument vlen edhe për mua, meqenëse e diskutuam edhe përpara. Pra i qëndroj...

**Naureda Llagami:** Atëherë, për të qenë konkret tani tek argumentet.

**Brikena Ukperaj:** Dakord me propozimin e Marçelës që edhe në Lezhë të hapen të gjitha, të dyja.

**Naureda Llagami:** Mund t'i përmbledhim propozimet?

E para, ju sugjeroni (edhe Marçela, edhe Brikena, edhe Ridvani) që të hapim të gjashtë pozicionet e Elbasanit. Gjashtë pozicione me ndarjen katër me dy.

**Brikena Ukperaj:** Katër me dy duke ruajtur raportin që ka sjellë Komisioni.

**Naureda Llagami:** Katër civile dhe dy penale.

Tre administrative në shkallë të parë dhe tek Lezha dy.

Pra bini dakord dy tek Lezha.

Hiqni dorë, pra jeni kundër transferimeve.

**Brikena Ukperaj:** Lezha në civile apo do t'i ndajmë një civile, një penale?

**Klodian Kurushi:** Në Gjykatën e Lezhës nuk ka aktualisht seksione civile dhe penale. Gjyqtarët gjykojnë si civile dhe penale. Ne për Lezhën kemi marrë ngarkesën totale të gjyqtarëve (civile dhe penale).

**Naureda Llagami:** Një civile, një penale.

**Brikena Ukperaj:** Lezha 11 gjyqtarë ka, kështu që dy seksione me nga gjashtë besoj se krijohen.

**Naureda Llagami:** Dakord, një civile, një penale.

Atëherë, hedhim në votim propozimet e bëra nga kolegët, pra për hapjen e gjashtë pozicioneve në Elbasan, katër civile dhe dy penale.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet me shumicë votash.)*

Miratohet propozimi i parë për hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për gjashtë pozicione të lira, katër pozicione në fushën e së drejtës civile dhe dy pozicione në fushën e së

drejtës penale.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi i dytë që ka të bëjë me hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Propozimi është për dy pozicione, një në fushën e së drejtës civile dhe një në fushën e së drejtës penale. Jeni dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet me shumicë votash.)*

Atëherë, Këshilli vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për dy pozicione, një në fushën e së drejtës civile dhe një në fushën e së drejtës penale.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi i tretë që ka të bëjë me hapjen e procedurave për lëvizjen paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Dakord.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Kundër.

*Naureda Llagami*: Dakord.

*(Miratohet me shumicë votash.)*

Atëherë, Këshilli vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative.

Afati i kandidimit do e lëmë sërish data 14 qershor 2023.

Ndërkohë, lidhur me çështjen/pikën e fundit që është për hapjen e procedurave të transferimit, kjo pikë u ezaurua tek pika e parë, kështu që nuk mund të hapen më procedurat e transferimit të përkohshëm.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve “Për shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...} / Për përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}”, të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

- |                            |                  |
|----------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i>       | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i>      | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
- 7. Përfaqësues të OPDAT-it.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...} / Për përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}”, të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Në fakt është çështje që vjen nga Komisioni i Administrimit të Buxhetit, ka të bëjë me shqyrtimin e dy projekt-akteve lidhur me kërkesën që ka parashtruar zoti {...} pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Luli, e cila është relatorja e këtij akti.

***Fatmira Luli:*** Faleminderit Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka qenë depozituar më datë 22.10.2020, kërkesa nga z. {...}, me anë të së cilës pretendonte se gëzonte statusin e këshilltarit /ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë, në përputhje me parashikimet e neneve 34, 84 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 165, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkonte njohjen e tij.

Me vendimin nr. 642, datë 23.12.2020 “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ndër të tjera: “1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga z. {...}, për deklarimin e pasjes së statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”.

Ky vendim erdhi si pasojë e vlerësimit të faktit se kërkimi përpara Këshillit ishte për shqyrtim në të njëjtën kohë edhe përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pra, ky vendim i ndërmjetëm u konkludua duke mbajtur në konsideratë parashikimin procedural civil, konkretisht nenin 36/3, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit asnjë institucion tjetër nuk mund të trajtojë çështje të cilat janë duke u trajtuar nga sistemi gjyqësor.

Këshillit të Lartë Gjyqësor i është komunikuar vendimi nr. 2416/2021, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ku është vendosur pranimi i pjesëshëm i padisë, dhe më pas vendimi i Gjykatës së Apelit me të cilin apeli ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2416/2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe rrëzimin e kërkesë padisë dhe të drejtën e ankimit.

Zoti {...}, pas këtij vendimi, ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën e protokolluar me nr.{...} prot., datë 24.03.2023, me anë të së cilës ai heq dorë nga kërkesa e tij e depozituar më parë në datë 22.10.2020. Në kërkesën e tij z. {...} pretendon se: “...Duke qenë se tashmë ka përfunduar gjykimi në të dyja shkallët e tij, heq dorë nga kërkesa drejtuar para jush në vitin 2020 dhe pushimin e shqyrtimit të saj...”.

Vlerësimi i Komisionit-

Në vendimin nr. 642, datë 23.12.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ndër

të tjera: “1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga z. {...}, për deklarimin e njohjes së statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”.... ”, në referim të parashikimit procedural civil, të cituar më sipër.

Vendimi nr. 221, datë 10.03.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit është një vendim i formës së prerë, që përbën titull ekzekutiv.

Në kushtet kur vetë kërkuesi z. {...} ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga kërkesa për njohje të statusit, Këshillit i duhet që të disponojë lidhur me shfuqizimin e vendimit nr. 642, datë 23.12.2020.

Ky disponim vendoset nga Këshillit në përputhje me nenin 68/2 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi jemi në kushtet kur shkaqet e ekzistencës së këtij vendimi kanë pushuar së ekzistuari.

Në datën 24.03.2023, z. {...} ka paraqitur pranë Këshillit kërkesën për heqje dorë nga shqyrtimi për njohjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, prandaj në këto kushte Këshillit i duhet që të disponojë lidhur me përfundimin pa vendim përfundimtar të kërkesës së mësipërme, konform nenit 90 dhe nenit 94/1, të Kodit të Procedurës Administrative, pasi në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.

Me qëllim për t'i garantuar një proces të rregullt në këtë procedurë, ky vendim i njoftohet palës së interesuar.

Me këtë propozim duhet që Këshilli të miratojë dy akte.

Akti i parë është “Për shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë gjykatës së lartë, të z. {...}”.

Në pikën e parë parashikohet shfuqizimi i vendimit të pezullimit.

Në pikën e dytë parashikohet që ky vendim i njoftohet z. {...}.

Në pikën e tretë parashikohet se kundër vendimit lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që merr Këshilli.

Në strukturën e vendimit të dytë “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të



shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë gjykatës së lartë të z. {...}”, në pikën e parë parashikohet përfundimi pa vendim i kësaj kërkesë.

Në pikën e dytë parashikohet që ky vendim i njoftohet palës.

Në pikën e tretë ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

Ky ishte propozimi.

**Naureda Llagami:** Faleminderit zonja Luli!

Për procedurë, nëse s’kemi diskutime kalojmë tek projekt-akti i parë që ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, të KLGJ-së “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. {...}”.

2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*Naureda Llagami:* Kalojmë ne projekt-aktin e dytë që relatoi znj. Luli, që ka të bëjë me përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. {...}. Jemi dakord?

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. {...}, për shkak të heqjes dorë nga kërkesa.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet z. {...}.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. {...}, ish-kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>        | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
- 7. Përfaqësues të OPDAT-it.*

**RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. {...}, ish-kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Brikena Ukperaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. {...}, ish-kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”, për më shumë detaje fjalën ia jap relatores znj. Ukperaj.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, ka filluar procedurën e

verifikimit të kancelarëve në detyrë, ndër të cilët ka qenë edhe z.{...}, ish-kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Gjatë procedurës së verifikimit të zhvilluar nga relatori i caktuar me short, është konstatuar se z.{...} ka ndërruar jetë në datë 08.02.2023, fakt që provohet nga të dhënat e certifikatës së vdekjes të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Berat përcjellë pranë relatorit nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bashkëngjitur informacionit të datës 23.02.2023.

Bazuar në sa më sipër dhe referuar vendimit nr. 424 të vitit 2020, në cilësinë e relatorit kam vlerësuar që kjo procedurë verifikimi nuk mund të vazhdojë më, sepse në zbatim të nenit 93 të Kodit të Procedurave Administrative i cili thirret për zbatim nga ligji “Për qeverisjen”, parashikohet nën titullin: “Vdekja e palës, mbarimi i personit juridik”, se: “Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen...”.

Verifikimi i kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, i pasurisë dhe figurës për kancelarin në detyrë, përbën çështje të karakterit personal të tij dhe si të tilla, verifikimi i tyre nuk mund të vazhdojë, nëse pala, subjekti i procedurës ndërron jetë.

Në këto kushte, çështja i është parashtruar për shqyrtim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit me propozimin tim për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi procedura zhvillohet për një çështje të karakterit personal, e të tillë që nuk mund të vazhdojë nëse pala ndërron jetë. Komisioni në datën 03.05.2023 ka miratuar propozimin dhe ka vlerësuar që materialet t’i përcillen për shqyrtim mbledhjes plenare.

Bashkëlidhur relacionit është përgatitur edhe projekt-akti përkatës, në pikën e parë të të cilit do të gjeni të formuluar si më poshtë:

1. Deklarimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z.{...}, ish-kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit

të bërë nga relatori.

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. {...}, ish-kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Atëherë, në eventualitetin që unë kam një angazhim, 5 minuta pushim, për ta vijuar mbledhjen me zotin Ilir Rusi “online”.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499 nr. 501, të datës 21.11.2022, si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502 të datës 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, (relator z. Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6 – nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499 nr. 501, të datës 21.11.2022, si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502 të datës 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, (relator z. Dritan Hallunaj).

***Ilir Rusi:*** Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Vazhdojmë me mbledhjen e ditës së sotme, tashmë në platformën “online”<sup>1</sup>, duke vazhduar me pikën 6 të rendit të ditës. Për më tej fjalën ia jap relatorit z. Hallunaj.

---

<sup>1</sup> Mbledhja “online” filloi në orën 13:55.



***Dritan Hallunaj:*** Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Po parashtroj relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidates, znj. {...}”.

Me Vendimin nr.499, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Me Vendimin nr.501, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale.

Në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 21.11.2022, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 05.12.2022.

Brenda afatit të kandidimit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet si më sipër, ka kandiduar gjyqtarja znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (në momentin e kandidimit e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor).

Me vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022, si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022 edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është caktuar relatori, ku për kandidaten znj. {...} jam caktuar unë si relator.

Më datë 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, i ndryshuar, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më datë 23.03.2023, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërgua formularët dhe autorizimet përkatëse si dhe Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, i ndryshuar, meqenëse verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidate do të kryhet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, bazuar në nenin 6 dhe nenin 57 pika 11 të Ligjit të ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.03.2023, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, i ndryshuar, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta

edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

Për këtë kandidate, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, meqenëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kandidatja ka qenë gjyqtare dhe i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Ky verifikim është në vijim e sipër si dhe do t’i përcillet për kompetencë Komisionit të Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, duke qenë se verifikimi i figurës për pozicionet në gjykatën e posaçme, për këtë kandidat, është objekt i veprimtarisë së tyre.

Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr.502, datë 21.11.2022, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr.499 dhe nr.501, datë 21.11.2022, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “b”, “c” “ç”, dhe “d” të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: “b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; ç) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi: d) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit

nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 502, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 502, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për kandidaten znj. {...}, u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me shkresën nr. {...} prot., datë 02.03.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës

penale/drejtësinë kriminale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë informacioni iu kërkua këtyre gjykatave. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjellë me shkresën nr. {...} prot., datë 23.03.2023, siç do të përshkruhet më poshtë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës informacioni i kërkuar është përcjellë me shkresën nr.{...} prot., datë 10.03.2023 siç do të përshkruhet më poshtë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, informacioni i kërkuar është përcjellë me shkresën nr.{...} prot., datë 13.03.2023 dhe përmes komunikimit elektronik të datës 06.04.2023, siç do të përshkruhet më poshtë.

Rezultatet e verifikimit paraprak për katër kriteret e kandidimit:

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499 dhe nr.501, datë 21.11.2022, është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të*

*përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2005, ndërkohë që ajo është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë 03.10.2005, ku ka vijuar deri më datë 14.11.2011. Në vijim ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri më datë 10.02.2020. Nga data 10.02.2020 deri më 10.02.2023 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Më datë 10.02.2023 kthehet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datë 12.07.2001 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2005. Me dekretin nr. {...}, datë 17.09.2004 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me dekretin nr. {...}, datë 03.10.2005 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me vendimin nr. {...}, datë 14.11.2011 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendim nr. 68, datë 06.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin “Këshilltar Ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një periudhë 2-vjeçare. Me vendim nr. 52, datë 08.02.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor përsëritet komandimi në pozicionin “Këshilltar Ligjor” në

Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një periudhë 2-vjeçare. Me vendim nr. 52, datë 27.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi para afatit të komandimit në pozicionin “Këshilltar Ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe nga data 10.02.2023 rikthehet në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 18 vite. Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 502 datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kandidaten rezulton si vijon:

Urdhri nr. {...}, datë 21.11.2011, “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. {...}, datë 21.01.2013, “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. {...}, datë 26.09.2013, “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil (Seksioni Tregtar Civil) të gjyqtarëve ({...})”;

- Urdhri nr. {...}, datë 03.03.2015, “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. {...}, datë 21.11.2016, “Për një ndryshim të urdhrin nr. 39, datë 03.03.2015 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. {...}, datë 01.03.2017 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. {...}, datë 10.07.2017 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

- Urdhri nr. {...}, datë 03.12.2019 “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

Duke qenë se sipas urdhrave të mësipërm, kandidatja rezultoi e caktuar pranë seksionit civil (tregtar), nga ana e relatorit u kërkua informacion shtesë pranë gjykatës, në funksion të verifikimit. Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes komunikimit elektronik të datës 07.04.2023 rezultoi që: Gjatë periudhës 01.01.2013 – 31.12.2013 (kërkesa penale -1); Gjatë periudhës 01.01.2014 – 31.12.2014 (kërkesa penale -2); Gjatë periudhës 01.01.2015 – 31.12.2015 (dosje penale – 1).

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për kandidaten rezultoi se për periudhën tetor 2004 – dhjetor 2005, ku gjyqtarja znj. {...} ka ushtruar stazhin profesional, ajo ka gjykuar në të dy seksionet, civil si dhe penal. Në këtë të fundit ajo ka gjykuar në total **79 çështje**.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për kandidaten rezultoi si vijon:

- urdhri nr. {...}, datë 06.01.2006 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezultoi pranë seksionit penal);

- urdhri nr. {...}, datë 31.01.2007 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezultoi pranë seksionit familjar);

- urdhri nr. {...}, datë 08.01.2009 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezultoi pranë seksionit civil të përgjithshëm);

- urdhri nr. {...}, datë 27.01.2011 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezultoi pranë seksionit civil);

Duke qenë se sipas urdhrave të mësipërm, kandidatja rezultoi e caktuar pranë seksionit civil, dhe vetëm gjatë vitit 2006 rezultoi në seksionin penal, nga ana e relatorit u kërkua informacion shtesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në funksion të verifikimit. Me anë të komunikimit elektronik të datës 06.04.2023, sipas kësaj të fundit, gjatë periudhës tetor 2005 deri nëntor 2011, kandidatja ka gjykuar çështje penale si vijon:



penale themeli – 107; masa sigurimi – 77, përgjime – 7; penale të veçanta – 70.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

“Dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit të sipërcituar, si kriter për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499 dhe nr. 500, datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili në fakt është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendës drejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të*

*personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet... ”.*

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar , kandidati ka depozituar:

- Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, znj. {...}, i datës 05.12.2022;

- Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit”, Shtojca B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshorti i kandidatit, z. {...}, i datës 05.12.2022.

Sa sipër, rezulton se kandidatja, dhe familjarët e tij të afërt, konkretisht bashkëshorti, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatës tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

“Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë dhe si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 501, datë 21.11.2022, dhe në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022 është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “d”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 501, datë 21.11.2022, dhe në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022 është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efiçenca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në

situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, relatori i çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në Mbledhjen e datës 04.05.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019 (i azhurnuar), si dhe në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr. 499, nr. 501, nr. 502, datë 21.11.2022, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 501, datë 21.11.2022 dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm)

për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

Ky ishte relacioni i përgatitur.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime nga anëtarët prezent në mbledhje?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 501, të datës 21.11.2022, si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin

nr. 502, të datës 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 501 dhe nr. 502, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500 të datës 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” (relator z. Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6 – nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**

**5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

**6. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500 të datës 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” (relator z. Dritan Hallunaj).

**Ilir Rusi:** Në vijim vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Faleminderit!

Vijojmë me relacionin e përgatitur “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e katër prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të kandidatit, z. {...}.



Me Vendimin nr.500, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

Në këtë procedurë ngritje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 21.11.2022, duke përfunduar afati i kandidimit më datë 05.12.2022.

Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin si më sipër, ka kandiduar gjyqtari z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022, si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022, si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Për kandidatin z. {...} jam caktuar unë si relator.

Më tej është njoftuar kandidati për fillimin e procedurës së verifikimit; për caktimin e relatorit di dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo të ndonjë anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga kandidati nuk është parashtruar ndonjë pretendim në lidhje me sa relatuam.

Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar

të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për këtë kandidat, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, meqenëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kandidati ka qenë gjyqtar dhe i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Ky verifikim është në vijim e sipër dhe do t’i përcillet për kompetencë Komisionit të Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve duke qenë se verifikimi i figurës për këtë kandidat është objekt i veprimtarisë së tyre.

Sipas dispozitave ligjore ku përcaktohet që për verifikimin e kushteve ligjore të kandidimit duhet që kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e të drejtës kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Gjithashtu “Kandidati duhet të japë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Gjithashtu “Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe “Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore”, dhe e fundit, “Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Për të gjitha këto është kërkuar informacion Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit si dhe gjykatave përkatëse.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”. Ka rezultuar, se sipas informacionit të paraqitur nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.2007 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekret nr. {...}, datë 10.11.2011 të

Presidentit të Republikës caktohet për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në datë 27.02.2019 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 17.03.2022 ku në këtë pozicion zgjidhet Znj. {...}, dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 11 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.500, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht urdhri nr. {...}, datë 26.07.2012, rezulton që çështjet civile dhe penale të ndodhura pranë gjyqtarëve {...}, etj., të jenë rihedhur në short, duke qenë se ata kanë përfunduar periudhën e kryerjes së stazhit profesional pranë kësaj gjykate.

Sipas informacionit të paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, sipas të dhënave statistikore të nxjerra nga gjykata, rezulton se z. {...}, gjatë periudhës 23 janar 2014 deri në 06.03.2023, ka gjykuar çështje gjyqësore të të gjithë kategorive, penale, civile, familjare.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.500, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 dhe ka rezultuar: Në lidhje me këtë kriter në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar: Formularin “Vetëdeklarim” Shtojca B, Deklarata 1,

plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, i datës 05.12.2022; Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve [...] Shtojca B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshortja e tij, znj. {...}, i datës 05.12.2022.

Sa sipër, rezulton se kandidati, dhe familjarët e tij të afërt, konkretisht bashkëshortja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Sipas informacionit rezulton që kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Për kandidaten z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar. Në këto kushte për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, relatori ia parashtroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision në mbledhjen e datës 04.05.2023, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancën plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur:

Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit [...], të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” apo të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”; si dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 500, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime nga anëtarët prezent për sa u relatua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Ilir Rusi:** Zonja Rupa!

**Yllka Rupa:** Pro. *(Për çështje teknike vota nuk dëgjohet në audio. Vota e zonjës Rupa shprehet nëpërmjet chat-it të platformës (shkruan) “Pro”).*

**Ilir Rusi:** Zonja Rupa votoi nëpërmjet komunikimit me “SMS” në platformë.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë më Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500 të datës 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.05.2023)

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6 – nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Në vijim vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.



***Klodian Kurushi:*** Faleminderit!

Relacioni i bashkëngjitet projektvendimit “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatit, z. {...}”.

Me Vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”.

Me Vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale.”.

Me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale.”.

Në lidhje me hapjen e tre vendeve të përmendura më lart, ka paraqitur kërkesë edhe kandidati z. {...}.

Në lidhje me rezultatet e verifikimit.

Pas paraqitjes së kërkesës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës filloi nisjen e procedurave për verifikimin e kriterëve paraprake dhe nga rezultatet e verifikimit paraprak për kriteret e verifikimit ka rezultuar se:

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 499 datë 21.11.2022, është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në

fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2003. Ndërkohë në datën 21.10.2003 emërohet gjyqtar ushtarak në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku ka gjykuar çështje me natyrë penale dhe administrative. Në vijim, prej vitit 2008 ai ka qenë pjesë e seksionit penal të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 07.07.2000 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2003.

Me vendimin nr. {...}, datë 21.10.2002 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i propozohet Presidentit të Republikës për t’u emëruar provizorisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 21.10.2003 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar ushtarak në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. {...}, datë 14.12.2015 të Konferencës Gjyqësore zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 12.12.2018, dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 20 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 499, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi 20 (njëzet) vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kandidatin z. {...}, i cili ushtron detyrën në seksionin penal rezultatet vijnë si më poshtë: nga data 1 janar 2003 deri në datën 31.12.2003, pra për të gjithë vitin 2003 ka rezultuar specifikisht se ky gjyqtar ka gjykuar 7 çështje penale. Pastaj ka gjykuar kërkesa penale gjithsej 14 dhe ka përfunduar 7 çështje penale.

Për vitin 2004 (po i referohem vetëm shqyrtimit të çështjeve me natyrë penale, pasi ai ka shqyrtuar çështje civile themeli, kërkesa civile, urdhra ekzekutimi, dosje penale, dosje penale ushtarake, kërkesa penale dhe kërkesa me të dëmtuar), pra për çështje penale, dosje penale ai ka gjykuar 28 dhe ka përfunduar 23, dosje penale ushtarake ka gjykuar 63 dhe ka përfunduar 29, kërkesa penale ai ka gjykuar 50 dhe ka përfunduar (nuk dëgjohet numri), dhe kërkesa me të dëmtuar ka gjykuar 1 dhe ka përfunduar 1.

Për vitin 2005, përtej çështjeve civile, kërkesave civile, urdhrave të ekzekutimit, ai ka shqyrtuar çështje penale, dosje penale, dosje penale ushtarake, kërkesa penale dhe kërkesa me të dëmtuar. Dosje penale ai ka gjykuar 20 duke përfunduar 10 prej tyre, dosje

penale ushtarake ka gjykuar 79 dhe ka përfunduar 12, kërkesa penale ka gjykuar 43 dhe ka përfunduar 10, dhe kërkesa me të dëmtuar akuzues ka gjykuar 10 të tilla.

Për vitin 2006, dosje penale ka gjykuar 45 dhe ka përfunduar 16, dosje penale ushtarake ka gjykuar 59 dhe ka përfunduar 22, kërkesa penale ka gjykuar 120 dhe ka përfunduar 25, kërkesa me të dëmtuar ka gjykuar 5 dhe ka përfunduar 2.

I njëjti trend vazhdon edhe për vitin 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

E gjithë statistika që lidhet me gjykimin e çështjeve penale, si dosje penale themeli, si kërkesa penale, si kërkesa me të dëmtuar, si dhe dosje penale ushtarake janë të pasqyruara në relacionin përkatës statistikat e çështjeve të përfunduara nga zoti {...} dhe unë për efekt kohe, nëse kolegët janë dakord po vijoj më tej me parashtrimin e relacionit, pasi në të gjitha këto vite rezulton që gjyqtari zoti {...} ka gjykuar një numër të konsiderueshëm çështjesh me natyrë penale (duke përfshirë çështje penale themeli, dosje penale ushtarake, kërkesa penale si dhe kërkesa me të dëmtuar akuzues).

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 499, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016.

“Dhënia e pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit të përmendur më lart është një kriter i cili është përcaktuar si i tillë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, i është referuar në nenin 47, pika 3, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të

përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili në fakt është një dispozitë referuese e cila referon konkretisht në nenin 48, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.95/2016, që përcakton se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet...”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kandidati ka depozituar: Formularin “Vetëdeklarim”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, i datës 05.12.2022; Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit”, Shtojca B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëjetuesja e kandidatit, që është nënshkruar dhe depozituar më datë 05.12.2022.

Sa sipër, rezulton se kandidati, dhe familjarët e tij të afërt, konkretisht bashkëjetuesja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

“Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në

gjykatën e shkallës së dytë dhe si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 48, pika 8, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që gjen reflektim në shkronjën “d”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Këshillat, gjatë ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efënca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Shqyrtimi nga Komisioni:

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 499, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, relatori i çështjes ia parashtrou rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në Mbledhjen e datës 19.04.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret formale të kandidimit të z. {...}, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, i ndryshuar, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, të vendosë dërgimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe

vendosur ky i fundit për:

Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 499, datë 21.11.2022, si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për sa u relatua?

***Brikena Ukperaj:*** Më fal zoti Rusi mund të bëj një pyetje për Klodin për ta sqaruar?

***Ilir Rusi:*** Po!

***Brikena Ukperaj:*** Numrat e saktë të pozicioneve?

Sepse në titullin e projekt-aktit janë specifikuar pozicionet 500 dhe 501 për gjykatën e shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërkohë në dispozitiv kemi pozicionet 499 dhe 502. Thjesht për të saktësuar cili është numri i pozicioneve i sakti.

Në titull kemi për pozicionet e shpallura me vendimet 500 dhe 501 për Gjykatën e



Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar. Në dispozitiv kemi thënë 499 dhe 502.

**Klodian Kurushi:** Keni të drejtë.

Do më jepni dy minuta kohë vetëm për ta verifikuar këtë pjesën.

**Brikena Ukperaj:** Vetëm për të saktësuar për të saktësuar numrat e pozicioneve.  
Kaq.

**Ilir Rusi:** Edhe 503 është përmendur.

**Klodian Kurushi:** Atëherë, në bazë të këtij verifikimi që kemi bërë, themi që vendet e hapura për pozicionet e lira janë të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022 (*përsëritet*).

**Ilir Rusi:** Atëherë zoti Kurushi, kur të bësh relatimin e titullit të projekt-aktit, relato që bëhet fjalë për këto vende të shpallura (499, 502 dhe 503), dhe pastaj kalojmë në votimin e saj tërësor.

**Klodian Kurushi:** Nuk e kuptova, më falni zoti Rusi. Edhe një herë.

**Ilir Rusi:** Kandidimi i tij është në raport me përcaktimet e vendimeve. Ndërkohë titulli i referohet disa vendeve të tjera. Meqenëse ju shpreheni që kandidon për vendimet e shpallura nga Këshilli me nr. 499, 502 dhe 503, ky ndryshim do reflektohet tek titulli i vendimit. Këtë do kërkoja nga ana juaj, që tani të bëjmë një relativitet të titullit, me qëllim që ne në një moment të dytë të kalojmë tek votimi.

**Klodian Kurushi:** Atëherë, titulli i projektvendimit “..verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të

shpallura me vendimet nr.502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

**Ilir Rusi:** Atëherë zoti Kurushi, nëse më lejon, tek titulli duhet të kemi, në vend të vendimit nr. 500, do jetë 499, dhe në vend të 501 është 502. Ky është reflektimi?

**Klodian Kurushi:** Atëherë, edhe një herë. Në vend të numrit 500 është 499. Më tej: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr.502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Pra numri 499 i korrespondon vetëm Gjykatës së Shkallës së Parë. Numrat 502 dhe 503 i korrespondojnë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

**Ilir Rusi:** Kjo që sapo thatë ju, përputhet me përmbajtjen e pikës 2 të projektvendimit.

**Klodian Kurushi:** Pikërisht.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit!

Ka diskutime të tjera për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, hedhim në votim projektvendimin, duke marrë në konsideratë reflektimet e bëra po nga relatori në lidhje me ndryshimet në titullin e vendimit, me qëllim përputhshmërinë e tij me përmbajtjen e vendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr.502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 499, datë 21.11.2022, si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |

- |                           |                  |
|---------------------------|------------------|
| <i>7. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Mar{...} Shehu</i>  | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i>     | <i>(anëtare)</i> |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6 – nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Më tej vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Kurushi.

***Klodian Kurushi***: Faleminderit!

Relacioni i radhës ka objekt paraqitjen e gjendjes së faktit dhe ligjit të zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatit z. {...}.

Me Vendimin nr.500, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur:

“1. Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”.

Me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale.”.

Me Vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e të drejtës penale.”.

Në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Korçë, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pikërisht në lidhje me tre vendet e përmendura më lart të hapura nga KLGJ-ja ka shprehur interesin edhe gjyqtari z. {...}.

Pas shprehjes së interesit nga ana e tij, Komisioni ka filluar procedurat përkatëse të verifikimit paraprak për kriteret e kandidimit. Pas verifikimit, rezultatet e paraqitura nga ky verifikim, sot po ia parashtrojmë mbledhjes së KLGJ-së. Dhe më konkretisht:

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 500 datë 21.11.2022, ku është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike

profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit parashikohet se: “Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, ku është parashikuar si kusht kandidimi kushtet e pasqyruara në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale (referuar sa më sipër), duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e së drejtës penale.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010, ndërkohë që ai është emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (gjatë periudhës së stazhit profesional) për periudhën 27 shtator 2010 deri në 21 dhjetor 2011, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Në vijim ai është emëruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ku vijon të ushtrojë funksionin dhe aktualisht si gjyqtar i shkallës së parë. Me vendim nr. 390, datë 28.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, funksion të cilin e ka



ushtruar deri më datë 01.03.2022.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 08.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010.

Me dekretin nr. {...}, datë 27.09.2010 të Presidentit të Republikës caktohet për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 21.12.2011 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Me vendimin nr. {...}, datë 28.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 01.03.2022 ku në këtë pozicion është zgjedhur z. Shehu, dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 12 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kandidatin z. {...}, rezulton që ka gjykuar nga janari 2010 deri në dhjetor 2010, 9 çështje civile themeli, 3 urdhra ekzekutimi dhe në total 12 çështje.

Në janar të vitit 2011 deri në dhjetor të vitit 2011, zoti {...} ka gjykuar dhe ka përfunduar 2 dosje penale, ka përfunduar 2 kërkesa penale si dhe ka gjykuar edhe çështje të tjera me natyrë civile, lëshim urdhrash ekzekutimi, kërkesa penale, etj.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Shkodër, për kandidatin rezulton se ka qenë pjesë e seksionit penal prej vitit 2013 dhe në vijim ka rezultuar se: Për vitin 2013-2014 z. {...} ka qenë pjesë e trupës gjyqësore penale në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër. Për periudhën 2014 ka qenë pjesë e trupës gjyqësore, Dhoma Penale dhe seksioni penal për të mitur. Për periudhën 2015 e në vijim ka qenë pjesë e dhomës penale dhe seksionit penal me të mitur në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër. Vendimi i Këshillit të gjykatës është i datës 22.06.2021 dhe nuk ka ndryshuar.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016; Për të mos e përsëritur edhe një atë çfarë thashë, është i njëjti verifikim që është bërë edhe për zotin {...}, specifikisht për zotin {...} ka rezultuar se:

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kandidati ka depozituar: Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, datë 05.12.2022; Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së tij), Shtojca B, Deklarata 3, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshortja e kandidatit, datë 05.12.2022.

Sa sipër, rezulton se kandidati, dhe familjarët e tij, konkretisht bashkëshortja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në

fuqi”, kriter ky i cili është përcaktuar në nenin 48, pika 8 e ligjit “Për statusin”, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masë disiplinore.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, kriter i cili është përcaktuar përtej Vendimeve të Këshillit nr. 500, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, gjën mbështetje ligjore në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Këshillat, gjatë ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, relatori i çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 19.04.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret formale të kandidimit të z. {...}, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, i ndryshuar, të Vendimeve të Këshillit nr. 500, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të vendosë dërgimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për:

Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të

kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime nga anëtarët prezent në mbledhje për sa u parashtrua nga relatori?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Mar{...} Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |

8. *Marçela Shehu* (anëtare)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6 – nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
3. *Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Më tej vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit!

Relacioni i radhës i referohet verifikimit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në



Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të z. {...}.

Me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 KLGJ-ja ka vendosur (në të tre rastet): Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Pas shpalljes së këtyre vendeve, zoti {...} kandidat ka paraqitur tre kërkesa të cilat i referohen tre vendeve të cilat unë përmenda më lart.

Pas paraqitjes së kërkesave nga zoti {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës filloi verifikimet paraprake për kriteret e kandidimit të këtij kandidati referuar nenit 48 e vijues të ligjit “Për statusit”.

Pas verifikimit janë nxjerrë rezultatet të cilat janë përfshirë në relacionin që po parashtroj përpara Këshillit dhe nga rezultatet e verifikuara ka rezultuar se:

Për kandidatin z. {...} u verifikua fillimisht kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, ku është parashikuar si kriter kandidimi, në nenin 47, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale (referuar sa më sipër), duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për

pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015, ndërkohë që ai është emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, (gjatë periudhës së stazhit profesional) për periudhën 31 tetor 2014 deri në 23 qershor 2016, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Në vijim ai është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ku vijon të ushtrojë funksionin dhe aktualisht. Me vendim të Këshillit ai është transferuar përkohësisht në Gjykatën e rrethit gjyqësor Pukë nga data 21.12.2018 deri më datë 11.09.2019.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015.

Me dekretin nr. {...}, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Me vendimin nr. 6, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Me vendimin nr. 176, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimi në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 8 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022,

rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për z. {...}, ka rezultuar se ai ka gjykuar në vitet 2014 dhe 2015, ku për vitin 2014 ai ka gjykuar çështje civile themeli, urdhra ekzekutimi, ndërsa nga janari 2015 deri në dhjetor 2016 ai ka gjykuar çështje civile themeli, urdhra ekzekutimi si dhe tre çështje penale.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për kandidatin ka rezultuar se:

Gjyqtari {...} ushtron funksionet e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër si më poshtë:

- Nga data 11.07.2016 deri më datë 21.12.2018, me vendimin nr. 6, datë 21.12.2018 të KLGJ-së është transferuar përkohësisht si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

- Nga data 11.09.2019 e në vijim ushtron funksionet e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, referuar vendimit të KLGJ-së nr. 176, datë 11.09.2021.

- Gjatë periudhës që ka ushtruar funksionet e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka qenë pjesë e seksionit penal prej vitit 2017 dhe në vijim.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, për kandidatin rezulton se: “...në referencë të viteve 2018-2019, për të gjithë periudhën që ka gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Pukë, gjyqtari ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile, penale, familjare, etj., pasi kjo gjykatë nuk është e ndarë në seksione.”

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, rezulton që kandidati ka mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e së drejtës penale.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm), kriter ky i parashikuar në Ligjin nr. 95/2016.

Nga verifikimet ka rezultuar se në formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, është plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, datë 05.12.2022; Formularin “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes), i parashikuar në Shtojcën B, Deklarata 3, është plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshortja e tij, znj. Oltjona Goxha, datë 05.12.2022.

Sa më sipër, rezulton se kandidati dhe familjarët e tij të afërt, konkretisht bashkëshortja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në Këshill, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”, datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në këtë gjykatë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në

detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Shqyrtimi nga Komisioni:

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, relatori i çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 19.04.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

*Ilir Rusi:* Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime nga anëtarët prezent për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

(Sipas radhës, pas zotit Hado duhet të kishte votuar z. Toro)

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e

Këshillit nr. 499, nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |



**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6 – nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**

**5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

**6. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).**

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Ilir Rusi:** Më tej vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit!

Atëherë, relacioni i radhës lidhet me gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatit z. {...} .

Me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: 1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale (tashmë gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm).

Në këtë procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit.

Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin si më sipër, ka kandiduar gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), i cili në momentin e kandidimit ka qenë gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm për vendet që i kemi thënë më lart.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë: Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi.

Me fillimin e procedurës së verifikimit relatori kreu të gjitha verifikimet e mundshme të parashikuara si të tilla nga nenet 46, 47, 48 të ligjit “Për statusin” rezultatet e të cilave fillimisht ai ia paraqiti KZHK-së dhe më pas këto rezultate i paraqet sot në këtë relacion përpara mbledhjes së KLGJ-së.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në

shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014, ndërkohë që ai është emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (stazhi profesional) për periudhën 21 tetor 2013 deri në 25 shtator 2015, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Në vijim ai është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ku ushtronte funksionet përpara se sa të përfundonte verifikimi i këtyre kriterëve në KZHK.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” në vitin 2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekretin nr. {...}, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës ai caktohet të kryejë stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Me procesverbal të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, datë 25.01.2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e

Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi 7 (shtatë) vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kandidatin z. {...}, rezulton si vijon tabela përmbledhëse: Janar 2013 – Dhjetor 2013 ka gjykuar çështje civile dhe urdhra ekzekutimi, gjithsej 64 çështje. Për Janar 2014 – Dhjetor 2014 ai ka gjykuar çështje civile themeli, urdhra ekzekutimi, dosje penale, gjithsej 56 çështje.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se nga verifikimet e kryera prej tyre, z. {...}, që nga emërimi si gjyqtar pranë kësaj gjykate ai ka gjykuar çështje si të natyrës civile dhe ato të natyrës penale. Kjo për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin si gjykatë e vogël nuk ka pasur një trupë gjyqësore të ndarë, pra trupa gjyqësore ka qenë e pandarë as në dhoma civile dhe as në dhoma penale dhe gjyqtarët e kësaj trupe gjykonin çështje të natyrës civile dhe çështje penale njëkohësisht.

Në mënyrë tabelare është paraqitur edhe ngarkesa e z. {...} ndër vite si gjyqtar, i cili rezulton që ka gjykuar në të njëjtën kohë si çështje civile ashtu edhe çështje penale.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati

z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 05.12.2022, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Shqyrtimi nga Komisioni:

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. nr. 503, datë 21.11.2022, relatori i çështjes ia parashtrroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 19.04.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr. 503 datë 21.11.2022, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 503, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të

kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022.

Faleminderit për vëmendjen!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë diskutime apo jo për sa u parashtrua.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Zotin Toro sikur nuk e dëgjova.

Zoti Toro!

**Alban Toro:** Dakord.

U dëgjova?

**Ilir Rusi:** Po! Faleminderit!

Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të

shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 503, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.05.2023)

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e kriterëve ligjore për kandidimin për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatës, znj. {...}”, (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |



*Shënim:* Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6 – nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e kriterëve ligjore për kandidimin për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatës, znj. {...}”, (relator z. Alban Toro).

*Ilir Rusi:* Për më tej vazhdojmë me pikën 12 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Në kushtet kur materiali i përgatitur nga KZHK është i përgatitur prej disa kohësh dhe i është vënë në dispozicion kolegëve, më lejoni ta paraqes në mënyrë të sintetizuar atë. Bëhet fjalë për “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatës, znj. {...}”.

Në kuadër të përpjekjeve që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor për të plotësuar

vakancat në sistemin gjyqësor dhe në mënyrë të veçantë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar apo në Gjykatën e Apelit të Tiranës, me vendimin nr. 501 dhe nr. 502, datë 21.11.2022, KLGJ ka vendosur përkatësisht: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...” dhe “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqararit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale”.

Një nga kandidatet që ka kandiduar për to është edhe zonja {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Në kuadër të plotësimit dhe verifikimit të kriterëve ligjore të kërkuara për këtë pozicion, të parashikuara nga nenet 8/3, 47/4, 48/8 të ligjit “Për statusin”, janë administruar aktet e nevojshme pranë KLGJ-së, të cilat do të konfirmojnë dhe provojnë plotësimin e këtyre kriterëve. Natyrisht, duke pasur parasysh që kandidatja në fjalë ka kandiduar edhe për pozicionin e hapur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të cilën kërkohen kriterë shtesë, pëlqimin që duhet të japë ajo dhe familjarët e tij apo mbarimi me sukses i procesit të pasurisë dhe figurës, natyrisht edhe në kuadër të këtyre kriterëve janë administruar aktet të cilat do të provojnë plotësimin e tyre.

Kështu për kandidaten në fjalë, nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën e posaçme, nga ana e relatorit janë administruar aktet e nevojshme si p.sh. me urdhrin nr. {...}, datë 01.12.2014 “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil të kandidateve për magjistrat”, kandidatja është caktuar në dhomën civile, seksioni civil”; Me urdhrin nr. {...}, datë 15.12.2014, “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil të kandidateve për magjistrat”, kandidatja është caktuar në dhomën civile, seksioni civil;  
- Me urdhrin nr. {...}, datë 29.01.2015, “Mbi pjesëmarrjen në shortin civil të kandidateve

për magjistrat”, kandidatja është caktuar në dhomën civile, seksioni civil;

- Me urdhrin nr. {...}, datë 24.05.2015, “Mbi pjesëmarrjen në shortin penal të kandidateve për magjistrat”, kandidatja është caktuar në dhomën penale, seksioni penal;

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë në rrugë postare dhe plotësimit të tij në rrugë elektronike nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për kandidaten z. {...} rezulton se për periudhën 2016 e në vijim në bazë të vendimeve dhe urdhrave, gjyqtarja ka gjykuar si vijon:

- Për periudhën qershor 2016 deri në dhjetor 2016 ka gjykuar në total 227 çështje, 8 çështje penale, 62 çështje civile , 56 kërkesa penale, 101 kërkesa civile;

- Për vitin 2017 ka gjykuar në total 346 çështje, 1 çështje penale, 125 çështje civile, 113 kërkesa penale, 107 kërkesa civile;

- Për vitin 2018 ka gjykuar në total 243 çështje, asnjë çështje penale, 61 çështje civile, 46 kërkesa penale, 136 kërkesa civile;

- Për vitin 2019 ka gjykuar në total 436 çështje, 201 çështje civile, 86 kërkesa penale, 149 kërkesa civile;

- Për vitin 2020 ka gjykuar në total 480 çështje, 0 çështje penale, 205 çështje civile, 89 kërkesa penale, 186 kërkesa civile;

- Për vitin 2021 ka gjykuar në total 909 çështje, 116 çështje penale, 192 çështje civile, 309 kërkesa penale, 292 kërkesa civile;

- Për vitin 2022 ka gjykuar në total 1024 çështje, 114 çështje penale, 202 çështje civile, 438 kërkesa penale, 270 kërkesa civile.

Nga të dhënat që rezultojnë dhe që janë administruar për efekt të procesit të verifikimit, rezulton që kandidatja {...}, e cila deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Gjithashtu është verifikuar dhe rezulton që të jenë plotësuar edhe aktet e nevojshme për dhënien e pëlqimit ajo dhe familjarët e vet për kontrollin periodik të

llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 ku rezulton të jetë dorëzuar edhe “Vetëdeklarimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidatja, znj. {...}, i datës 28.02.2023 dhe Formulari “Vetëdeklarim (i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendës drejtorit, etj., etj., plotësuar më datë 28.02.2023.

Natyrisht janë administruar edhe aktet që provojnë që nuk ka shkaqe të tilla që do të pengonin konkurrimin e mëtejshme të saj, siç janë ndonjë masë disiplinore në fuqi apo ekzistenca e papajtueshmërisë ambientale në rastin hipotetik të ngritjes së saj në detyrë pranë dy gjykatave.

Kështu që, në përfundim, nga ana e relatorit, pasi ia ka kaluar Komisionit i cili është dakordësuar për ndjekjen e procedurës, i është kaluar projekti Këshillit të Lartë Gjyqësor ku ju sugjerohet të miratoni si vijon:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 501 dhe nr. 502, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për sa u relatua.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 501 dhe nr. 502, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm)

për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.05.2023)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Gjirokastrë, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, Krujë” (relator z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 16:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*. Znj. Llagami nuk merr pjesë në çështjet me nr. 6-nr.13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**

**5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Gjirokastër, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, Krujë” (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Për më tej vazhdojmë me pikën 13 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit!

Atëherë, po bëj një prezantim të përmbledhur nëse kolegët janë dakord, të relacionit të fundit që ka për objekt deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Gjirokastër, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, Krujë. Siç dihet, këto gjykata në kuadër të riorganizimit, për efekt edhe të hartës, janë përfshirë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë dhe Shkodër. Ndodhur në këto kushte, kërkesat e tyre që janë paraqitur në Këshill për plotësimin e trupave gjyqësore përpara sesa të merrej vendim për riorganizimin edhe një



herë në kuadër të hartës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ne kemi vlerësuar se këto kërkesa pas riorganizimit kanë ngelur pa objekt sepse nga informacionet shtesë që kemi marrë na ka rezultuar që këto çështje janë rihedhur në short në kuadër të plotësimit të trupave gjyqësore.

Ndodhur në këto kushte, ne si Komision i Zhvillimit të Karrierës i propozojmë Këshillit që nëse ai e shikon të arsyeshme, të marri një vendim në lidhje me deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të paraqitura konkretisht: nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, kërkesat me Nr. 1526/1, 401, 390;

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: nr. 223, 228, 233, 241, 271, 290 të vitit 2023 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Lushnjë (që në kuadër të riorganizimit është pjesë aktualisht e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: nr. 265, 268, 309, 333 (*lapsus, 330 sipas relacionit*), 356, 398, 416 të vitit 2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet (që në kuadër të riorganizimit tashmë ky rreth përfaqësohet nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: nr. 146, 191 të vitit 2023 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (në të cilin është përfshirë edhe ish-Gjykata e Shkallës së Parë Përmet).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: nr. 332, 2630, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (që në kuadër të riorganizimit është përfshirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: nr. 232, 272 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës (që në kuadër të riorganizimit për efekt të hartës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës është përfshirë edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, nën Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Kukës).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: nr. 127, 128, 170 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë (tashmë qendra e së cilës ndodhet në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: nr. 61/473 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë (e cila në kuadër të riorganizimit tashmë është përfshirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: nr. 03, 114 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (e cila në kuadër të riorganizimit në këtë gjykatë është përfshirë edhe ish-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, nën Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Lezhë).

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: nr. 448, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin e cila me riorganizimin e ri, ndodhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi përkatës për deklaruar të përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Përmet, Gjirokastrë, Pogradec, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, për ato çështje të cilat unë i parashtrova në relacionin bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Nëse kolegët kanë ndonjë pyetje, ne jemi të gatshëm për të dhënë shpjegime. Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u përket.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për deklarinimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit

të kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Gjirokastrë, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, Krujë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Përmet, Gjirokastrë, Pogradec, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, Krujë, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë

i. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 1526/1, 401, 390 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë

ii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 228, 233, 241, 271, 290 të vitit 2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet

iii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 265, 268, 309, 330, 356, 398, 416 të vitit 2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë

iv. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: Nr. 146, 191 të vitit 2023 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec

v. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 332, 337 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës

vi. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 232, 272 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë

vii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 127, 128, 170 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin

viii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 448, 553, 554, 555 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

ix. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 03, 114 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë

x. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: Nr. 61/473 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarëve të gjykatave të sipërcituara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike janë shqyrtuar të gjitha pikat e përcaktuara në rendin e ditës së mbledhjes së ditës së sotme.

Mbledhjen e deklarohet të mbyllur.

Duke ju uruar një pasdite të qetë.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**